

VENDIM
Nr. 107, datë 22.4.2021

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 242, DATË 21.12.2020, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘HEC ZALL XHUXHË’ SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 92, pikat 1 dhe 2, si dhe të nenit 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 22.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 56/2 prot., datë 19.4.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 242, datë 21.12.2020,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 242, datë 21.12.2020, ka vendosur të licencojë shoqërinë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, me kushtin që shoqëria të depozitojë, brenda 3 muajve nga marrja e këtij vendimi:

i. vërtetimin për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore;

ii. dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, etj.);

iii. sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për t’u tregtuar në gWh, për pesë vitet e licencës së tregtimit të energjisë elektrike;

iv. kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

- Ky vendim i është njoftuar shoqërisë me shkresën e ERE-s nr. 1165/3 prot., datë 24.12.2020, tërhequr dorazi nga përfaqësuesi i shoqërisë në datën 27.12.2020.

- Duke qenë se në përmbushje të afatit të përcaktuar në vendimin nr. 242/2020, shoqëria nuk kishte depozituar në ERE dokumentacionin përkatës, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 451 prot., datë 16.3.2021, duke i rikujtuar detyrimin për plotësimin e kushteve të mësipërme.

- Në përgjigje, me shkresën nr. 7 prot., datë 12.4.2021, protokolluar në ERE me nr. 451/1 prot., datë 12.4.2021, shoqëria ka depozituar në ERE vërtetimin për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore. Me depozitimin e këtij dokumenti, shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 1, germa “i”, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 242/2020, ndaj ky kusht shfuqizohet, bazuar në përcaktimet e nenit 113, të KPA-së.

- Po ashtu, shoqëria ka depozituar shkresën e protokolluar në ERE me nr. 451/2 prot., me anë të së cilës ka deklaruar se dokumentacioni është dërguar me vonesë nga ana e saj, për shkak të infektimit të stafit administrativ të shoqërisë me *COVID-19*, çka ka sjellë pamundësinë e shoqërisë për të plotësuar dokumentacionin e kërkuar brenda afatit, si dhe ka kërkuar mirëkuptimin e ERE-s për të shtyrë me 30 ditë afatin e plotësimit të dokumentacionit të përcaktuar në kushtet e vendimit nr. 242/2020, që lidhen me veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Duke marrë në konsideratë vullnetin e shoqërisë, për të plotësuar një pjesë të dokumentacionit, për të përmbushur kushtet përkatëse të vendosura në vendimin e licencimit, vlerësohet se duhet marrë parasysh kërkesa e saj për të shtyrë afatin për plotësimin e kushteve të vendimit nr. 242/2020. Duke qenë se nga data 27.3.2021, si afati i fundit për të depozituar dokumentacionin përkatës nga

shoqëria, ka kaluar pothuajse një muaj, vlerësohet që afati për plotësimin e kushteve të vendimit nr. 242/2020, të zgjatet me 60 ditë, duke filluar ky afat nga data 28.3.2021, duke përfshirë në këtë mënyrë dhe afatin e kaluar tashmë dhe për t'i dhënë mundësinë shoqërisë që të plotësojë kushtet e vendimit 242/2020.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 242, datë 21.12.2020, pika 1:

Ishte:

“1. Të licencojë shoqërinë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, me kushtin që shoqëria të depozitojë brenda 3 muajve nga marrja e këtij vendimi:

i. vërtetimin për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore;

ii. dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.);

iii. sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për t'u tregtuar në gWh, për pesë vitet e licencës së tregtimit të energjisë elektrike;

iv. kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.”.

Bëhet:

“1. Të licencojë shoqërinë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, me kushtin që shoqëria të depozitojë brenda 60 ditëve, duke filluar ky afat nga data 28.3.2021:

i. dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.);

ii. sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për t'u tregtuar në gWh/për pesë vitet e licencës së tregtimit të energjisë elektrike;

iii. kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.”.

2. Drejtorja e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti